

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Shofer pune/transporti

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

1. Për çdo lëvizje që bën duhet të ketë një Urdhër Pune apo Autorizim përkatës,
2. Për çdo lëvizje që bën është i detyruar të mbajë dhe të plotësojë fletë udhëtimet përkatëse.
3. Duhet që me rigorizitet të respektojë rregullat e qarkullimit rrugor.
4. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e automjetit te tij. Për këtë qëllim çdo drejtues bën kontrollimin ditor të automjetit për nivelin e ujit dhe i ftohjes, nivelin e vajit për frenim dhe në motorr, dritat e përparme, të pasme si dhe të sinjaleve, veglat për ndreqjen e defekteve dhe mjetet shtesë, gomat, rrjedhjet e mundshme të vajit, ujit dhe dëmtimet e tjera, etj., si dhe inspektimin ditor gjatë përdorimit për sistemin e drejtimit (timonin) dhe frenat.
5. Shpenzimet që do të kryhen nga shoqëria për riparimin si pasojë e trajtimit neglizhent, keqpërdorimit, dëmtimeve për shkak aksidenti dhe shpenzimeve për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor do të përballohen nga paga e përdoruesit të automjetit.
6. Të zbatojë në çdo kohë, me korrektësi të plotë, rregullat e caktuara për masat e sigurimit teknik në punë, duke mbajtur përgjegjësi për shkeljen e tyre.
7. Në rast aksidenti, përdoruesi i automjetit është i detyruar ta denoncojë atë menjëherë por në të gjitha rastet jo më vonë se 24 orë, pavarësisht nga lloji dhe cilësia e dëmit apo nga fakti nëse dëmi është i mbuluar apo jo nga policia e sigurimit të mjetit.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do te vleresohen ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.